

VENDIM
Nr. 64, datë 11.4.2022

MBI KUALIFIKIMIN DHE PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGINËS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “MOGLICË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA, PËR VITIN 2020 DHE 2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 3, germa “ë” dhe nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 4, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 432/2 prot., datë 4.4.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kualifikimin dhe pajisjen me ‘Certifikatë të garancisë së origjinës’ (GO) për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC ‘Moglicë’, të shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a. për vitin 2020 dhe 2021”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 16.3.2022, vendosi të fillojë procedurën për kualifikimin dhe pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 262/4 prot., datë 23.3.2022 dhe me shkresën nr. 262/3 prot., datë 23.3.2022, i kërkoi OST sh.a. informacion në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të injektuar në rrjet nga impianti prodhues i HEC “Moglicë” për vitin 2020 dhe vitin 2021, si dhe destinacionin e kësaj energjie elektrike brenda apo jashtë vendit.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 262/5, datë 30.03.2022, ka përcjellë informacionin e kërkuar dhe ka konfirmuar sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC “Moglicë” për vitet 2020 dhe 2021 dhe në lidhje me destinacionin e kësaj energjie, rezulton se veprimtaria është kryer përmes transaksioneve elektroenergetike në treg të liberalizuar brenda dhe jashtë vendit.

- HEC “Moglicë” nuk ka qenë më parë i pajisur me GO dhe ky është aplikimi i parë i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për kualifikim dhe pajisjen me GO të HEC-it “Moglicë”, i cili ka filluar operimin në datën 6.4.2020.

- Certifikata e Garancisë së Origjinës do të lëshohet për energjinë e prodhuar gjatë vitit 2020 (159,723 mwh) dhe për atë të prodhuar gjatë vitit 2021 (424,643 mwh), sasi kjo e konfirmuar nga OST sh.a. në zbatim të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar si më poshtë:

- aneksi 1, formati i aplikimit, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- neni 7, pika 7.4, kërkesa për lëshimin e GO, germat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, plotësuar;
- 7.5, dokumentacioni teknik, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- neni 8, “Procedura teknike e kualifikimit”, pikat 8.1, 8.2 dhe 8.3, germat: “a”, “b”, “c” (i, ii, iii, iv), “d” (i, ii, iii), 8.4, plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikoj impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

2. Të pajisë me certifikatën e garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për periudhën 1.1.2020–31.12.2020, për sasinë e prodhuar 159,723 mwh dhe për periudhën 1.1.2021–31.12.2021, për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 424,643 mwh.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti